



Tiranë, më 27.10.2017

NJOFTIM

Mbështetur në Vendimin e Rektoratit me Nr.156, datë 27.10.2017 “Për rishpalljen e pranimin e personelit akademik me kohë të pjesshme për vitin akademik 2017 – 2018 ne Fakultetin e Veprimtarisë Fizike e Rekreacionit”, njoftohen të gjithë kandidatët e interesuar që duan të aplikojnë për personel akademik me kohë të pjesshme (pedagog të jashtëm), që duke filluar nga data 27.10.2017 deri më 02.11.2017, duhet të dërgojnë më anë të shërbimit postar në Protokollin e Universitetit të Sporteve të Tiranës dokumentacionin përkatës.

- Curriculum Vitae (e detyrueshme).
- Diplomën dhe Certifikatën e notave të studimeve Bachelor (fotokopje)
- Diplomë dhe Certifikatën e notave të studimeve Master i Shkencave ose DIND (fotokopje) (e detyrueshme)
- Certifikatën e gradës Doktor i Shkencave (fotokopje)
- Dëshminë e titullit Profesor i Asociuar (nqs ka) (fotokopje)
- Dëshminë e titullit Profesor (nqs ka) (fotokopje)
- Të vërtetojë që nuk është i dënuar penalisht (vetëdeklarim) (e detyrueshme)
- Fotokopje të kartës së identitetit (fotokopje) (e detyrueshme)
- Numrin e llogarisë bankare. (nqs ka)
- Vërtetim nga qendra e punes per t’u angazhuar si pedagog i ftuar ne institucionin tonë. (nqs është i punësuar) (e detyrueshme) si dhe leja nga titullari i institucionit ku punon.
- Librezë shëndetësore nga Drejtoria e Shëndetit Publik (dorëzohet nëse shpallet fitues)

Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit

- | | |
|---|-----------------|
| - Sociologji (Bachelor/M.Profesional) | 1 (një) Lektor, |
| - Shkenca Sportive (M.Profesional) | 1 (një) Lektor |
| - Ekonomi- Financë në Sport (M.Profesional) | 1 (një) Lektor |

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:

- Të jetë diplomuar në Specialitetin e lëndës përkatëse ku konkuron
- Nota e mesatare e ciklit të parë të studimeve (Bachelor) duhet të jetë mbi 8-të;
- Të ketë gradën Doktor Shkencor.
- Të zotërojë nje gjuhë te huaj (preferohet gjuha angleze).
- Të ketë njohuri për njohjen e programeve bazë kompjuterike
- Kanë preferencë pedagogër më grada e tituj : Prof.Dr.; Prof.Asc.Dr.; Dr.
- Preferohen pedagogët qe kanë pervojë në mësimdhënie në shkollën e lartë.
- Të kete veprimtari shkencore si: referime, botime, studime.

- Vlerësohen kualifikime të ndryshme në nivel pasuniversitar që i përkasin fushës së lëndës në departamentin ku aplikon.

Vetem paketat e aplikimit të mbërritura me anë të shërbimit postar pranohen dhe data në vulën e Postës Shqiptare do të shërbejë për të përcaktuar respektueshmërinë e afatit të aplikimit të kandidatëve.

Në zarf duhet të shënohet adresa e sakte e aplikimit, Universiteti i Sporteve të Tiranës, Fakulteti ku konkurron, Departamenti, emri, mbiemri, Nr. telefonit dhe e-mail të konkurentit.

Prof. Dr. Agron CUKA

R E K T O R

Konceptoi: Luiza Shehu

Drejtoreshë: Frida Jasa

Administratore: Mirlinda GALUSHI

Numri i kopjeve origjinale : 3 (tre)